VENDIM
Nr. 131, datë 7.6.2018

MBI KËRKESËN E KESH SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 98, DATË, 30.4.2016, MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 53, 56 dhe 59, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë"; nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike mbi kërkesën e KESH sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2016, "Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018", të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 98, datë 30.4.2018, ka miratuar kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OSHEE sh.a.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën e saj nr. 2680/1 prot., protokolluar në ERE me nr. 382/1 prot., datë 22.5.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, "Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018".

- Shoqëria KESH sh.a. e ka përcjellë me *e-mail*, fotokopje dhe jo nga adresa zyrtare e shoqërisë KESH sh.a., shkresën nr. 2680/1 prot., në datën 21.5.2018, si dhe përtej orarit zyrtar të punës në ERE.

- Neni 53 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, parashikon se afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim "afatet procedurale", përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

- Në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikohet se: Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Në nenin 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", parashikohet se: Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Neni 56 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me llogaritjen e afateve kur ato janë në ditë, parashikon: "Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati".

- Në lidhje me depozitimin e kërkesës, neni 59 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë parashikon se: Në përputhje me pikat 1 deri në 4, të këtij neni, kërkesa mund t'i paraqitet drejtpërdrejt organit publik brenda orarit zyrtar.

- Neni 13, i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, parashikon se kryetari i bordit është administratori i përgjithshëm i ERE-s. Ai është përgjegjës për administrimin e institucionit.

- Me qëllim ushtrimin e detyrave e kompetencave të tij, kryetari i ERE-s përcakton orarin zyrtar të punës. Për këtë qëllim, në zbatim të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar, si dhe urdhrit të kryetarit të ERE-s nr. 64, datë 29.12.2017, është vendosur se orari zyrtar i punës për punonjësit e ERE-s është nga ora 08:00 deri në orën 16:30.

- Kërkesa e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, "Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018", është depozituar jashtë afatit të parashikuar në nenin 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neneve 53, 56 dhe 59, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

- Nga ana e shoqërisë KESH sh.a., nuk është parashtruar asnjë provë e re, në kërkesën e saj për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, "Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018", siç parashikohet në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, mbështetur në pikën 5 të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe nenin 16 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë kërkuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti